



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

2007

PLANI I INTEGRUAR I MINISTRISË



Mesazhi i Ministrit

Plani i Integruar i Ministrisë së Mbrojtjes, si pjesë e procesit të Planifikimit Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një tjetër tregues i rëndësishëm që lidhet me zbatimin e objektivave të marra nga Qeveria Shqiptare në fushën e mbrojtjes, duke synuar hartimin e planeve dhe programeve konkrete për arritjen dhe përmbushjen e misionit kushtetues të FA dhe përpjekjeve për realizimin e integritit në strukturat Euro-Atlantike.

Samiti i NATO-s zhvilluar në Rigë, dha sinjalet më pozitive të mundshme për Shqipërinë. Ftesa për anëtarësim është e pritshme në më pak se dy vjet për ne dhe partnerët tanë të Kartës së Adriatikut, Kroacinë dhe Maqedoninë. Vlerësimi i Rigës ishte mesazh i qartë për mbështetjen e rrugës së drejtë të Qeverisë, reformës në çdo sektor të vendit për të vendosur shtetin ligjor dhe padyshim vlerësim i reformave të kryera në fushën e mbrojtjes.

Samiti i Rigës përcaktoi sfida të reja të aspektit të sigurisë dhe atij ushtarak, ne patjetër, që duhet t'u përgjigjemi atyre. Kontributi ynë në shërbim të paqes është shprehje e qartë se ne NATO-n e shikojmë si një familje ku do të japim kontributin tonë për sigurinë dhe stabilitetin.

Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura, si në angazhimet brenda vendit, ashtu edhe në operacione në mbështetje të paqes. Ato po tregojnë se janë një instrument i mirëndërtuar, me personel të motivuar e të përgatitur profesionalisht.

Për t'iu përgjigjur më mirë sfidave të sotme e të ardhme të sigurisë Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura kanë ndërmarrë fillimin e një sërë ndryshimesh strukturore, të cilat do ta bëjnë forcën tonë ushtarake, vërtet të vogël, por profesioniste, të stërvitur e të pajisur shumë mire, të aftë për përmbushjen e misionit. Me kryerjen në vazhdim të reformave, Forcat tona të Armatosura kanë bërë progres të konsiderueshëm në zhvillimin e Forcave të afta të mbështetura nga buxheti i mbrojtjes duke e lidhur ngushtë këtë zhvillim me planifikimin financiar të Qeverisë, për të eliminuar ose zvogëluar stafe të panevojshme ose që kërkojnë shumë shpenzime, dhe për të ndërtuar struktura dhe njësi të pajisura dhe të trajnuara më mirë.

Disa nga prioritetet më të rëndësishme të Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2007 do të jenë:

Implementimi i Strukturës së re e Forcave të Armatosura (FA);

Rritja e nivelit operacional të FA, veçanërisht të strukturave të përcaktuara si prioritare të angazhuara në misione humanitare e në mbështetje të paqes brenda e jashtë vendit.

Rritjen e profesionalizmit të FA duke kaluar gradualisht në një forcë plotësisht profesionist brenda vitit 2010;

Modernizimi i FA në sipas një programi të konsoliduar për arritjen e standarteve të NATO-s

Vazhdimi i pjesëmarrjes në Operacionet/Misionet e drejtuara nga NATO/BE/OKB dhe Koalicioni Botëror Kundër Terrorizmit;

Të gjitha strukturat e Forcave tona të Armatosura janë të angazhuara të përmbushin këto prioritete. Përmirësimi i planizimit dhe aftësive të menaxhimit të strukturave tona të komandimit dhe stafeve, për të plotësuar standardet e NATO-s, është faktori kyç në këtë drejtim. Stërvitjet e fundit të suksesshme kanë qënë një testim për kapacitetet tona në rritje dhe strukturat që përmbushin standardet e NATO-s, për të realizuar operacionet luftarake, humanitare dhe ato në mbështetje të paqes.

Periodha deri në Samitin e ardhshëm të zgjerimit të NATO-s është tepër e shkurtër. Është në dorën tonë ta bëjmë atë të frytshme përmes realizimeve që kompozojnë performancën e nevojitur për të merituar anëtarësimin në Aleancën e Atlantikut të Veriut. Tani është koha për të realizuar përgjegjësitë tona. Ne nuk mund të humbasim kohë, angazhimi ynë është solemn, i bazuar në shërbim të Atdheut, Nderit dhe Detyrës. Ne kemi një ëndërr shqiptare për të realizuar: anëtarësimi ne NATO.

Ju Faleminderit!

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Fatmir Mediu', written on a light blue background.

Ministër i Mbrojtjes

Fatmir MEDIU

Pasqyra e lëndës

1	Misioni i Ministrisë.....	2
2	Dokumenta strategjike të Ministrisë	3
3	Programet buxhetore të Ministrisë	5
4	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2007.....	7
5	Plani i Monitorimit të Ministrisë	12
Aneks 1	Projekt-ligjet për tu paraqitur	13
Aneks 2	Rezultate që lidhën me Programin e Qeverisë	14
Aneks 3	Rezultate që lidhën me integrimin Europian	15
Aneks 4	Rezultate që lidhën me anëtarisimin në NATO	16
Aneks 5	Investimet publike	18
Aneks 6	Projekte të ndihmës së huaj	19

1 Misioni i Ministrisë

Ministria e Mbrojtjes ka për mision ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të veta në përputhje me Kushtetutën, Strategjinë e Sigurisë Kombëtare, Politikën e Mbrojtjes, Strategjinë Ushtarake dhe ligjet e tjera të Republikës së Shqipërisë për hartimin dhe zbatimin e politikave shtetërore që sigurojnë mbrojtjen e vendit.

Ministria e Mbrojtjes është përgjegjëse përpara Presidentit të Republikës, Parlamentit dhe Këshillit të Ministrave për mbrojtjen e vendit duke zbatuar funksionet e mëposhtme:

- Përfaqësimin në organet e lartpërmendura dhe në Këshillin e Sigurimit Kombëtar duke dhënë mendim të specializuar për problemet e mbrojtjes, zhvillimit të Forcave të Armatosura dhe integritimit në NATO
- Pasqyrimin në programin e zhvillimit perspektiv të FA, të politikave dhe direktivave të qeverisë në fushën e mbrojtjes, në fushën sociale, në atë të integritimit, zhvillimit e modernizimit të FA në nivelin e kërkesave të kohës
- Sigurimin e marrëdhënieve të qëndrueshme me bazë mirëbesimi në fushën ushtarake, ndërmjet shteteve
- Ndërtimin e politikave dhe praktikave që favorizojnë bashkëpunimin, përcaktimin e prioriteteve dhe synimeve të cilat krijojnë hapësira bashkëpunimi në interes të rritjes së sigurisë kolektive dhe plotësimin e interesave të vendit
- Ndërtimin e politikave të përshtatshme arsimimi për të gjithë personelin e FA duke synuar shkallë të lartë motivimi
- Standardizim të veprimtarisë së brendshme në FA dhe integrim normal në shoqëri
- Sigurimin e mbarëvajtjes së brendshme në FA në përputhje me zhvillimet e tjera shoqërore duke siguruar menaxhim optimal të burimeve njerëzore, financiare e materiale, me qëllim që zhvillimi e modernizimi i FA të jetë kurdoherë e në çdo rrethanë në përputhje me zhvillimet politike e ushtarake në rajon e më gjerë
- Hartimin e programeve të bashkëpunimit me të gjitha institucionet e tjera shtetërore në funksion të angazhimeve të tyre ligjore për zbatimin e kërkesave të Strategjisë së Sigurimit dhe Politikës së Mbrojtjes, si për mbrojtjen e vendit ashtu edhe për përballimin e fatkeqësive natyrore

2 Dokumenta strategjike të Ministrisë

Strategjia sektoriale e mbrojtjes

Synimi i Ministrisë së Mbrojtjes është të zhvillojë dhe të mbështesë një forcë ushtarake të bashkuar të aftë dhe të përballeshme, e cila do t'u shërbejë nevojave për siguri të vendit, stabilitetit në rajon dhe do të sigurojë kapacitetet e duhura për të kontribuar me forca të dislokueshme në operacionet e përbashkëta me Aleatët, me objektiv marrjen e ftesës për anëtarësim në NATO në Samitin e ardhshëm në Uashington në 2008.

Qëllime

Politika e këtij sektori është hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

- Arritja e standardeve të punës dhe aktiviteteve të krahasueshme me ato të NATO-s, duke bere të mundur transformimin e Forcave të Armatosura Shqiptare në një forcë të mirëpërgatitur, të mirëpajisur me kapacitetet e nevojshme dhe të afta për të marre pjesë në misionet dhe detyrat e ngarkuara brenda dhe jashtë vendit.
- Arritja, zhvillimi dhe mbajtja e kapaciteteve të plota operationale të forcave të luftimit, sipas standardeve të NATO-s, deri në vitin 2010. Rritja dhe vazhdimi i kontributit në Operacionet në Mbështetje të Paqes.
- Mbështetja e procesit të transformimit të Forcave të Armatosura për realizimin e objektivit të reduktimit të reparteve të panevojshme dhe krijimin e një force me të vogël në numër, por të pajisur dhe të stërvitur mirë, operationale, të dislokueshme dhe të ndërveprueshme si ndërmjet forcave, ashtu edhe me ushtritë e vendeve të NATO, e afte për të përmbushur misionin e saj dhe standardet për anëtarësim në NATO.
- Të mbështesë Forcat e Armatosura sipas Planit të Zhvillimit Afatgjatë, objektivave të Integrimit në NATO dhe BE, dhe objektivave të Ministrisë së Mbrojtjes të shprehura në Programin e Qeverisë 2005-2009. Të mbështesë realizimin e Objektivave të Partneritetit (PG), dhe angazhimeve ndërkombëtare të Forcave të Armatosura dhe synojë në arritjen e standardeve dhe procedurave kompatibel me ato të NATO. Të paraprijë zhvillimin e Forcave të Armatosura me punë kërkimore dhe të hedhe vizionin e së ardhmes nëpërmjet metodave të punës që janë në kuadrin e aktiviteteve të shërbimeve që ky program mbulon.
- Parapërgatitja e mjedisit për mbështetje politike, shoqërore, ekonomike, financiare, njerëzore e infrastrukturore të veprimtarisë operationale të Forcave të Armatosura. Planifikimi dhe koordinimi i veprimtarive të Forcave të Armatosura në përputhje me mundësitë, kapacitetet për përbalimin e emergjencave dhe mbrojtjen e popullsisë, ekonomisë, mjedisit e pasurisë. Sigurimi i mbështetjes së domosdoshme ndaj autoriteteve civile për shërbimet publike dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për promovimin e ligjit dhe vendosjen e rendit kushtetues kur ato janë cenuar dhe strukturat përkatëse ligjore e kanë të pamundur ose nuk funksionojnë.
- Përgatitja, zhvillimi dhe zbatimi i projekteve, planeve e programeve dhe koncepteve doktrinale të stërvitjes e të arsimimit ushtarak për të formuar e zhvilluar një forcë ushtarake të mirarsimuar, të ndërveprueshme me strukturat e NATO-s; ngritja dhe zhvillimi i arsimimit ushtarak universitar në nivelin e standardeve universitare në Shqipëri dhe standardeve akademike ushtarake të NATO-s. Konsolidimi i shkollave të trupës për kualifikimin e ushtarëve profesionistë, nënoficerëve dhe oficerëve për të përmbushur detyrat funksionale sipas specialiteteve përkatëse. Përgatitja, zhvillimi e zbatimi i programeve për zotërimin e gjuhës së huaj për të arritur nivelet e STANAG 6001.
- Parandalimi i sëmundjeve dhe epidemive. Konservimi i fuqisë njerëzore nëpërmjet ruajtjes së jetës dhe minimizimit të paaftësive reziduale mendore dhe fizike. Riaftësimi i forcave në kohe paqejë, konflikti dhe krize. Arritja e standardeve të kërkuara në fushën e shërbimit

shëndetësor për anëtarësimin në strukturat euroatlantike. Rritja e cilësisë së shërbimit ndaj pacientëve nëpërmjet përmirësimit të diagnostikimit dhe trajtimit spitalor.

- Nëpërmjet trajtimit financiar të ushtarakeve në rezerve e në lirim përgatitja e një mjedisi të mirë për integrimin e tyre të natyrshëm në ekonominë e tregut duke i shmangur nga problemet social-ekonomike.

3 Programet buxhetore të Ministrisë

3.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Politika e këtij programi konsiston ne sigurimin e mbështetjes me burimet financiare dhe materiale, infrastrukturën e duhur, kushtet normale për punë e aktivitet te stafeve te MM, SHPPFA, Komandave te Forcave, formacioneve dhe përfaqësueseve te Forcave te Armatosura Shqiptare ne interes te realizimit te misioneve dhe detyrave te ngarkuara brenda dhe jashtë vëndit.

3.2 FORCAT E LUFTIMIT

Politika e këtij programi konsiston ne sigurimin e një Force Luftimi operacionale, te mirëstërvitur dhe profesioniste, te ndërveprueshme me NATO-n, te afte për te kryer operacione luftarake dhe joluftarake, për te përmbushur detyrimet kushtetuese për mbrojtjen e vendit, forcimin e sigurisë ne rajon e me gjere si dhe mbështetjen e autoriteteve lokale për emergjencat civile.

3.3 MBESHTETJA E LUFTIMIT

Politika e këtij programi konsiston ne rritjen e operacionalitetit te reparteve te luftimit dhe te mbështetjes me shërbime për te siguruar transformimin dhe modernizimin e Forcave te Armatosura dhe përmbushjen e detyrimeve ushtarake për anëtarësimin e ardhshëm ne NATO.

3.4 MBESHTETJA E PERQENDRUAR

Politika e këtij programi konsiston ne mbështetjen e strukturave te FA me informacion, pajisje e teknologji kohore dhe shërbime te tjera qe ndikojnë ne ruajtjen dhe zhvillimin e kapaciteteve operacionale te pranueshme për anëtarësimin ne NATO.

3.5 BASHKEPUNIMI CIVILO-USHTARAK (AL-CIMIC)

Politika e këtij programi konsiston ne mbështetjen e Ministrisë se Mbrojtjes, Shtabit te Përgjithshëm, strukturave te Forcave te Armatosura për përmbushjen e misionit te tyre kushtetues, nëpërmjet vendosjes se marrëdhënieve, bashkëpunimit e koordinimit me te gjithë aktoret civile e organizmat e tjerë te shoqërisë ne hapësirën operacionale, ne te cilën përfshihen popullsia civile, autoritetet, subjektet e agjencitë e ndryshme lokale e ndërkombëtare, organizata joqeveritare lokale, kombëtare e ndërkombëtare.

3.6 MBESHTETJE SHENDETESORE

Politika e këtij programi konsiston ne sigurimin e mbështetjes mjekësore cilësore, parësore dhe te specializuar, për efektivat e FA brenda dhe jashtë vendit, për familjaret e tyre, për ushtaraket e huaj me mision ne vendin tone, personeli i Ministrisë se Brendshme (police dhe ushtarake), ushtaraket e Ministrisë se Drejtësisë si dhe mbështetja e komunitetit civil për trajtimin e politraumës.

3.7 ARSIMI USHTARAK

Politika e këtij programi konsiston ne organizimin, zhvillimin, drejtimin dhe realizimin e përgatitjes, arsimimit e kualifikimit të oficerëve, nënoficerëve e drejtuesve të Forcave te Armatosura; zhvillimi i koncepteve doktrimore të organizimit e të përdorimit të Forcave te Armatosura dhe i koncepteve e programeve të arsimimit dhe të stërvitjes; përpunimi e zbatimi i standardeve e kërkesave për stërvitjen ne funksion te rritjes se aftësive te Forcave te Armatosura, për te përmbushur misionin e tyre kushtetues dhe standardet e anëtarësimit ne NATO.

3.8 MBESHTETJE SOCIALE PER USHTARAKET

Politika e këtij programi konsiston ne faktin qe ne bashkëpunim me ISSH te behet trajtimi financiar i ushtarakëve ne rezerve, lirim e pension ne zbatim te ligjeve ne fuqi, riintegrimin e ushtarakeve te liruar ne shoqërinë civile, si dhe plotësimi i kërkesave te domosdoshme për jetese.

4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2007

Sipas programeve, Ministria do të ofrohet produktet të mëposhtme në 2007. Këto janë produktet ku konsiston Plani i Monitorimit të Ministrisë.

4.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Objektivat e politikës

- Te filloje zbatimin e projekteve 01, 03, 04, 05, 08, 09, 10, 14 dhe te sigurohet mbështetja me burime financiare për modernizimin në vazhdimësi të infrastrukturës së nevojshme për punë dhe aktivitet, të stafëve të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm, Komandave dhe misionëve ushtarakë jashtë vendit.

Produktet që do të ofrohen

- Sigurimi i funksionimit normal të stafit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm.
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe i kushteve të punës në godinën e MM e SHPFA.
- Përshtatja e objekteve ekzistuese për sigurimin e standardeve për punë të Komandës së Forcës së Bashkuar si dhe mbështetja me infrastrukture për Sistemin e Vëzhgimit të Hapësirës Detare.
- Përshtatja e zgjerimi i sistemit IT, krijim sistemi administrim, arkivim e përpunim informacioni sipas standardeve të NATO-s si dhe sigurimi i transparencës me publikun.

4.2 FORCAT E LUFTIMIT

Objektivat e politikës

- Për BrRSH (mbajtja e nivelit k1 me b2k, arritja e nivelit k2 me b3k dhe arritja e nivelit k3 me elementet e tjerë).
- Për Batalionin e Artilerisë mbajtja e nivelit k4.
- Për Regjimentin Komando arritja e nivelit k2. Për Regjimentin e Helikopterëve arritja e nivelit k4 (futja e 2 helikopterëve BO-105 dhe 2 helikopterëve AB-205).
- Për Distriktet Detare D1D dhe D2D arritja e nivelit k3, si dhe blerja e një Anije Patrulluese të Madhe.
- Vazhdimi i kontributit në operacionet paqeruajtëse në Bosnje-Hercegovinë, Irak dhe Afganistan.

Produktet që do të ofrohen

- Mbajtja e forcave të luftimit në KFB.
- Ndërtime dhe rikonstruksione për përmirësimin e kushteve të punës, jetesës dhe stërvitjes në këto reparte .
- Riparimi dhe mirëmbajtja e Helikopterëve BO 105 dhe AB 205.
- Pajisja e efektivit të Brigadës së Reagimit të Shpejte dhe Regjimentit Komando me pajisje ushtarake sipas standardeve të NATO-s.
- Sigurimi anijeve patrulluese për strukturat e Rojes Bregdetare (Distrikteve Detare).

4.3 MBESHTETJA E LUFTIMIT

Objektivat e politikës

- Mbështetja e reparteve të OCC dhe ato të deklaruara për mundësinë e angazhimit të tyre në operacionet shumëkombëshe të drejtuara nga NATO.
- Mbështetja e batalionit të II të BrRSh.
- Mbështetja e reparteve prioritare (BrRSh, Regjimenti Komando, Brigada e Stërvitjes Bunavije, Regjimenti i Helikopterëve, Rojes bregdetare).
- Mbështetja e programeve të modernizimit të Forcave të Armatosura dhe zhvillimit të infrastrukturës.
- Përqendrimi dhe asgjësimi i municioneve.
- Eliminimi i stokeve dhe materialeve të tepërta. Kodifikimi dhe automatizimi i të dhënave logjistike.
- Zvogëlimi i numrit të bazave si dhe përqendrimi i depove të rezervave materiale.
- Zhvillimi i kapaciteteve të Forcave të Armatosura për Mbështetjen e Vendit Pritës.
- Rritja e kapaciteteve operacionale me 5 % (synimi është arritja e nivelit operacional K2).

Produktet që do të ofrohen

- Rikonstruksione të depove të municionit, materialeve, truproja dhe rrjete të ndryshme.
- Vazhdimi i projektit të ndërtimit të Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Detare.
- Përmirësimi i 1 sistemi të komunikimit të FA në përputhje me standardet e NATO-s.
- Blerja e pajisjeve që do të sigurojnë mirëmbajtjen e helikopterëve.
- Sigurimi i pajisjeve për kompletimin e zyrave dhe ambienteve të Reparteve të FA sipas standardeve të kërkuara.

4.4 MBESHTETJA E PËRQENDRUAR

Objektivat e politikës

- Zhvillimi i kapaciteteve të pranueshme operacionale, të Qendrës së Riparimit të Nivelit IV, Kantierit të Riparimit të Anijeve, Uzinës së Riparimit të Avionëve për mirëmbajtjen dhe sigurimin e gatishmërisë së mjeteve dhe pajisjeve në shërbim të nivelit të kërkuar operacional në misionet e stërvitjeve.
- Sigurimi i kapaciteteve të nevojshme për komandim, drejtim, komunikim, informim të nivelit strategjik, operativ dhe taktik të FA.
- Mbështetje tekniko-shkencore e aktivitetit operacional dhe administrativ i strukturave të FA.

Produktet që do të ofrohen

- Sigurimi i komunikimit dhe ndërlidhjes së pandërprerë në të gjithë Forcat e Armatosura, nëpërmjet një strukture të nivelit të trete operacional.
- Informacion i pandërprerë për kërcënimet koherente për SHPFA, ofruar nëpërmjet një strukture.
- Shërbime logjistike dhe studime për F.A., ofruar nëpërmjet 6 strukturave.
- 25 riparime të pjesshme për mjetet lundruese.
- Sigurimi i gatishmërisë së lartë për ruajtjen e institucionit, ofruar nëpërmjet 1 strukture.

- Sigurimi i gatishmërisë së helikopterëve dhe kontrollit të hapësirës ajrore, ofruar nëpërmjet 3 strukturave.
- Organizimi i 375 veprimtarive edukative e kulturore.
- Sigurimi i informacioneve sekrete për Ministrinë e Mbrojtjes, ofruar nëpërmjet 70 strukturave operacionale.

4.5 BASHKEPUNIMI CIVILO-USHTARAK (AL-CIMIC)

Objektivat e politikës

- Konsolidimi dhe plotësimi i strukturave operacionale të AL-CIMIC në përputhje me kërkesën e PG3780 II. "Plotësimi me personel të strukturës së CIMIC".
- Identifikimi dhe trajnimi i personelit të ekipit të specialistëve funksional të AL-CIMIC, sipas kërkesës së PG3783II "Ekipi i specialistëve funksional të CIMIC".

Produktet që do të ofrohen

- Sigurimi i rekrutimit të shtetasve në përputhje me kërkesat organike të Forcave të Armatosura nga Qendrat e Rekrutim Mobilizimit (QRM), sipas 12 treguesve operacionale.
- Sigurimi i kushteve të përshtatshme për ruajtjen e jashtme, mirëmbajtjen dhe vendosjen e standardeve për të gjithë institucionet të përfshira në këtë program.
- Mbështetja e komunitetit civil dhe strukturave të Forcave të Armatosura nga ana e (, Brigadës së Mbrojtjes Rajonale.
- Konsolidimi i komandave të reja rajonale (Elbasan, Shkodër, Gjirokastër, Korçë, Burrel, Kukës) nga shkrirja e brigadave rezerviste si struktura Mbështetëse në varësi të Forcave Tokësore, nëpërmjet 6 kapaciteteve operacionale.

4.6 MBESHTETJE SHENDETËSORE

Objektivat e politikës

- Plotësimi i PG për vitin 2007.
- Sigurimi i mbështetjes mjekësore Rol 1 dhe 1+ për të gjitha të gjitha strukturat e FA.
- Sigurimi i rezervave të vaksinave kundër anthrax dhe kundër lisë për trupat tona që shkojnë me mision jashtë vendit, sidomos në vende me rrezikshmëri të lartë operacionale. Pas kësaj periudhe sigurimi i rezervave të vaksinave do të bëhet në përputhje me numrin e trupave që shkojnë në këto misione.
- Përgatitja e një toge shëndetësore për pjesëmarrjen në operacionet dhe stërvitjet e PfP.

Produktet që do të ofrohen

- Trajtimi spitalor i pacientëve të ardhur nga FA të MM.
- Trajtimi spitalor i pacientëve të ardhur nga MBr dhe SHISH.
- Trajtimi spitalor i pacientëve të ardhur nga komuniteti civil.
- Trajtimi në urgjencë dhe shërbimin ambulator i pacientëve që vijnë nga FA.
- Trajtimi i pacientëve që vijnë nga MB dhe SHISH në shërbimin urgjencës dhe atë ambulator.
- Trajtimi i pacientëve të ardhur nga komuniteti cilin në shërbimin e urgjencës dhe atë ambulator.
- Rikonstruksion objekt në SUQU.

4.7 ARSIMI USHTARAK

Objektivat e politikës

- Realizimi dhe mbështetja e procesit mësimor në institucionet arsimore dhe në shkollat e trupës, për kryerjen e kurseve të parashikuara në planin afatgjatë të zhvillimit të Forcës.
- Shtimi dhe përmirësimi i bazës mësimore didaktike dhe i mjeteve të automatizimit.
- Mbështetja e arsimimit dhe stërvitjes me botime doktrinale, manuale, tekste, etj.

Produktet që do të ofrohen

- 450 kualifikime të reja në kuadër të modernizimit të sistemit arsimor dhe ushtarak në KDS.
- Trajnimi i ushtarakeve në shkollat e trupës së forcave.
- Sigurimi i internetit në KDS, zgjerimi dhe përsosja e bazës mësimore didaktike në interes të procesit stërvitor, kompletimi me mjete transporti.
- Realizimi dhe mbështetja e procesit mësimor në institucionet arsimore dhe në shkollat e trupës, për kryerjen e kurseve të parashikuara në planin afatgjatë të zhvillimit të Forcës.
- Mbështetja e arsimimit dhe stërvitjes me botime doktrinale, manuale, tekste, etj.
- Fillimi i punës për ngritjen e qendrës së simulimit për përgatitjen e oficerit të shtabit. Zgjerimi dhe fuqizimi i rrjetit të pikave të kontaktit në nivel lokal për barazinë gjinore dhe PAK me 64 persona.

4.8 MBESHTETJE SOCIALE PËR USHTARAKET

Objektivat e politikës

- Planifikimi i numrit dhe i masës së përfitimit sipas kategorive të përfituesve.

Produktet që do të ofrohen

- Mbështetja financiare sipas legjislacionit në fuqi për 20 688 ushtarake të F.A. në rezerve të lirimit, për përfitimet për pension të parakohshëm, vjetërsi shërbimi dhe pension suplementar.

Tabela Buxheti 2007 sipas programeve dhe llojeve te shpenzimeve, milion Lek

Programet	Pagat dhe kontribute e sigurimeve shoqërore 600, 601	Mallra dhe shërbime 602	Subveconet 603	Te tjera transfertë korrente 604, 605	Transferta pre buxhetet familjare dhe individët 606	Shpenzime kapitale 230, 231	Total
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	763	480	0	0	0	183	1,426
Forcat e luftimit	1,956	1,625	0	0	0	1,907	5,490
Mbështetja e luftimit	1,045	1,482	0	0	0	1,581	4,109
Mbështetja e përqendruar	1,002	291	0	0	0	308	1,600
Bashkëpunimi civilo-ushtarak (AL-CIMIC)	723	169	0	0	0	0	893
Mbështetje shëndetësore	190	245	0	0	0	752	1,187
Arsimi ushtarak	634	286	0	0	0	328	1,248
Mbështetje sociale për ushtaraket	0	0	0	2,161	0	0	2,161
Total	6,317	4,579	0	2,161	0	5,062	18,119

5 Plani i Monitorimit të Ministrisë

Treguesit	Njësia	Qëllimi
Forcat e luftimit		
Numri i anijeve patrulluese te mëdha	Cope Leke/000	1 905,000
Numri i forcave paqeruajtëse ne Bosnje-Hercegovine, Irak dhe Afganistan	Persona	216
Pajisje Luftarake Individuale	Leke/000	377,583
Ndërtime e Rikonstruksione Objektsh	Objekte Leke/000	11 246,380
Mbështetja e luftimit		
Ndërtime e Rikonstruksione Objektsh	Objekte Leke/000	8 154,400
Numri i makinerive e pajisjeve qe sigurojnë mirëmbajtjen e helikopterëve	Numër Leke/000	60 77,900
Mbështetja e përqendruar		
Ndërtime e Rikonstruksione Objektsh	Objekte Leke/000	10 185,640
Numri i riparimeve për mjetet lundruese		25
Numri i veprimtarive edukative e kulturore		375
Bashkëpunimi civilo-ushtarak (AL-CIMIC)		
Numri i shtetasve te rekrutuar për FA	Persona	2 300
Numri i komandove rajonale		6
Mbështetje shëndetësore		
Numri i pacienteve te trajtuar nga komuniteti civil	Persona	27 000

Aneks 1 Projekt-ligjet për tu paraqitur

Gjate vitit 2007 Ministria e Mbrojtjes do të paraqesë paketën ligjore të re në funksion të implementimit të strukturës së re të Forcave të Armatosura.

Aktet ligjore kryesore që do të rishikohen gjatë vitit 2007 janë:

- Projekt-ligj “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 8671” datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Projekt-ligj “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 9171” datë 22.1.2004 “Për gradat e karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.
- Projekt-ligj “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 9069” datë 15.5.2003 “Për policinë ushtarake në Forcat e Armatosura”.
- Projekt-ligj “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 8907” datë 6.6.2002 “Për funksionimin e Institutit Gjeografik Ushtarak të Shqipërisë”.
- Projekt-ligj “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 9074” datë 29.5.2003 “Për Shërbimin Informativ Ushtarak”.
- Projekt-ligj “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 9419” datë 20.5.2005 “Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë”.
- Projekt-ligj “Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr. 8875” datë 4.4.2002 “Për Rojën Bregdetare”.

Aneks 2 Rezultate që lidhën me Programin e Qeverisë

Rezultatet e Planit të Integruar të Ministrisë së Mbrojtjes lidhen drejtpërdrejt me realizimin e objektivave të marra në Programin e Qeverisë Shqiptare për periudhën 2005-2009. Arritjet me kryesore të këtij viti janë:

- Reformimi dhe transformimi i Forcave të Armatosura, si pjesë e Sistemit të Sigurisë Kombëtare, për t'ju përgjigjur më mirë të gjitha sfidave në fushën e ruajtjes së sigurisë kombëtare, rajonale dhe globale.
- Respektimi i dokumenteve kryesore në fushën e sigurisë të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë në fushën e mbrojtjes si: Strategjia e Sigurimit Kombëtare, Strategjia Ushtarake e RSH, si dhe rishikimin e tyre periodik në konsensus me forcat e tjera politike dhe parlamentare.
- Konsolidimi i institucionit të mbrojtjes, si pjesë e forcimit të institucioneve demokratike të shtetit shqiptar, në përputhje me detyrave të shtruara nga Samitet e fundit të NATO-s (Samitet e Pragës, Stambollit dhe Rigës) të shtruara për vendet partner dhe aspirante.
- Përmbushja e detyrimeve të Planit të Veprimit për Anëtarësim në NATO, sidomos ato të fushës së mbrojtjes ushtarake në përputhje me kërkesat e NATO-s, rekomandimet e saj të shprehura në “progress reports” etj.
- Forcimi i bashkëpunimit dypalësh, shumëpalësh dhe me organizatat ndërkombëtare si NATO, BE, OKB dhe OSBE.
- Forcimi i bashkëpunimit rajonal duke luajtur një rol aktiv në nismat rajonale sidomos ato në kuadër të SEDM-it, A-3, Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore, Adrion, SEEC.
- Kontributi për sigurinë globale duke marrë pjesë në operacionet dhe misionet e drejtuara nga NATO në Afganistan, BE në Bosnjë-Hercegovinë, Koalicionin kundër Terrorizmit në Irak, si dhe pjesëmarrja në Misionin e OKB-së në Gjeorgji.
- Zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit Evropian për arritjen e standardeve të kërkuara të demokracisë, garantimin e kufijve, respektimin e të drejtave të njeriut, luftën kundër krimit të organizuar, trafikëve të paligjshme, korrupsionit etj.
- Rritja e transparencës dhe informimit të publikut duke përmirësuar punën me teknologjinë e informacionit, bashkëpunimit me organizatat jo-fitimprurëse për përfshirjen e publikut në procesin e vendimmarrjes për problemet e sigurisë dhe mbrojtjes së vendit.
- Konsolidimi i strukturave të specializuara për koordinimin dhe monitorimin e reformave evropianizuese.

Aneks 3 Rezultate që lidhën me integrimin European

Menaxhimi i kufijve

- Projekti i Modernizimit të Sistemit të Vëzhgimit të Hapësirës Detare (projekti parashikohet të përfundojë në për vitin 2009 ku parashikohet blerja e 7 radarëve te vëzhgimit te hapësirës detare).
- Blerja e 1 anije te madhe patrulluese (janë planifikuar te blihen 4 anijeve të tilla deri në vitin 2009).
- Marrja e 3 helikopterëve BO-105 ne kuadrin e kontratës me palën Gjermane (pjesë e paketës prej 6 Helikopterësh).
- Pajisja e 6 anijeve ekzistuese me Sistemin Automatik të Identifikimit dhe me Kapacitete të Vëzhgimit Natën.

Krimi i organizuar dhe trafiqet e paligjshme

- Rritja e kapaciteteve në luftën kundër trafikut ilegal.
- Konsolidimi i strukturave ekzistuese ne Policinë Ushtarake, Shërbimin Informativ Ushtarak për shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin me strukturat e tjera te shtetit.

Lufta kundër terrorizmit

- Rritja e kapaciteteve të Zyrës së Luftës kundër Terrorizmit në Shërbimin Informativ Ushtarak për zbatimin e detyrimeve të MM që rrjedhin nga “Plani Kombëtar i Veprimit Kundër Terrorizmit” (miratuar me VKM Nr.12 dt. 28.1.2002).
- Trajnimi dhe pajisja e personelit me mjetet e nevojshme për luftën kundër terrorizmit.

Pjesëmarrja ne operacionet e drejtuara nga BE

- Ruajtja dhe zhvillimi i kapaciteteve për pjesëmarrjen ne operacionin ALTHEA në Bosnjë-Hercegovinë të drejtuar nga BE.
- Planifikimi i strukturave dhe kapaciteteve për pjesëmarrjen ne Operacionet e drejtuar nga BE në Liban.
- Përgatitja e një kompanie këmbësorie për pjesëmarrje në operacionin në Liban.

Aneks 4 Rezultate që lidhën me anëtarisimin në NATO

Transformimi i FA në përputhje me Konceptin Strategjik të Aleancës

- Përgatitja e Strategjisë Ushtarake brenda muajit Mars 2007.
- Rishikimi dhe miratimi i Doktrinës së Përbashkët të Forcave të Armatosura brenda muajit Tetor 2007
- Kryerja e transformimit dhe implementimi i strukturës së re të FA për sigurimin e konceptit “joint” dhe “jointness”, sipas standardeve të NATO-s.

Modernizimi i FA për rritjen e kapaciteteve operacionale

- Përgatitja dhe miratimi i Planit të Modernizimit të Sistemeve dhe Pajisjeve për Forcat e Armatosura brenda muajit Prill 2007.
- Realizimi i programit të modernizimit të QOSA-s për përfshirjen në Sistemin e Integruar të Mbrojtjes Ajrore të NATO-s (NATINEADS).
- Përgatitja e Katalogut të Kapaciteteve HNS (HNS CAPCAT database), trajnimi i specialistëve përkatës dhe kompletimi i bazës ligjore të nevojshme për këtë qëllim.

Përgatitja për të kontribuar me Forca dhe Kapacitete për operacionet dhe misionet e Aleancës

- Kontributi me personel të komponentit tokësor në nivelin prej 6% për operacionet jashtë vendit dhe 25% për sigurimin e rotacioneve, brenda vitit 2007.
- Përgatitja e kontingjenteve dhe pjesëmarrja në Operacionin ISAF, Afganistan me një togë me Turqinë dhe një kompani me Italinë, sigurimi i rotacionit çdo 6-muaj.
- Përgatitja e kontingjenteve dhe pjesëmarrja në Operacionin “Liria e Irakut”, Irak me një kompani këmbësorie dhe sigurimi i rotacionit çdo 6-muaj.
- Përgatitja dhe pjesëmarrja në Ekipin e Përbashkët Mjekësor në Afganistan, në kuadër të A-3, dhe sigurimi i rotacionit të radhës çdo 6-muaj.
- Planifikimi për heqjen e kufizimeve “caveat” për kontingjentet tona kombëtare gjatë vitit 2007, dhe përgatitja për të kontribuar me forca në vitin 2009 në “Pool of Forces” të NRF (NATO Response Force), si dhe në komponentët ushtarakë të Bashkimit Europian (EU Battle Groups).
- Përgatitja e një personeli civil dhe ushtarak prej 60 vetësh (30 vetë gjatë vitit 2007 dhe 30 vetë gjatë vitit 2008), për të plotësuar vendet e ofruara në strukturat e NATO-s me marrjen e ftesës së anëtarësimit.
- Planëzimi i pjesëmarrjes në operacionin e NATO-s “Active Endeavour” në Detin Mesdhe.
- Ratifikimi i marrëveshjeve me NATO-n në fushën e menaxhimit të hapësirës ajrore, përkatësisht për situatat RENEGADE, për Klerancat Diplomatieke dhe zhvillimin e programit Shkëmbimit të të Dhënave të Situatës Ajrore (ASDE).

Pjesëmarrje aktive në programet dhe mekanizmat e Partneritetit për Paqe (PfP)

- Përgatitja e dokumenteve kryesore të integritit në NATO, si IPP, PARP, MAP (përkatësisht Gusht, Shtator, Tetor).

- Forcimi i bashkëpunimit me Komandat Strategjike të NATO-s: ACT dhe ACO, duke zhvilluar në mënyrë të veçantë bashkëpunimin konkret me JFC Napoli.
- Zgjerimi i rrjetit të përdoruesve të sistemeve online të NATO-s si PRIME, NSA ADL, nga 30 vete që ka aktualisht në më shumë se 100 vete.
- Pjesëmarrja në Programin e Zgjeruar të Arsimit dhe Stërvitjes (TEEP) me NATO-n, brenda vitit 2007.

Rritja e ndërveprimit dhe standardizimit

- Arritja e Niveli 1 i operacionalitetit për tre batalione të BrRSH.
- Vlerësim i NATO-s për Nivelin 1 të OCC për nënrepartet e k1b2 BrRSH dhe nëngrupi i AME, KML.
- Vetëvlerësim për Nivelin 1 të OCC-se për nënrepartet e k2b2k dhe togës shëndetësore të BrRSH.
- Kompletimi 100% me personel të trajnuar të njëjësive prioritare sipas STANAG-ut 6001.
- Futja në përdorim e STANAG-eve të NATO-s që lidhet me implementimin e Objektivave të Partneritetit për Vitin 2007.

Rritja e bashkëpunimit rajonal dhe bilateral

- Thellimi i mëtejshëm i bashkëpunimit në kuadër të A-3 dhe të SEDM-it, sidomos për ndërmarrjen e projekteve, stërvitjeve dhe operacioneve të përbashkëta, dhe bashkëpunimi për ngritjen e një Kolegji Rajonal të Mbrojtjes.
- Implementimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit dypalësh dhe zgjerimi i bashkëpunimit me të gjitha vendet e NATO-s.
- Pjesëmarrje aktive në nismat dhe iniciativat rajonale si Adrion, SEEC, RACVIAC etj.
- Zbatimi i konventave dhe marrëveshjeve në kuadër të Arme-Kontrollit, duke realizuar të gjitha kuotat e inspektimeve, vlerësimeve, dhe shkëmbimit të informacionit.
- Rritja e bashkëpunimit me organizatat, institutet e specializuara në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Menaxhimi i burimeve të mbrojtjes

- Harmonizimi i sistemit të planifikimit dhe programimit të mbrojtjes me Sistemin e Planifikimit të Integruar kombëtar (SPI).
- Integrimi i të gjithë programeve të mbrojtjes me Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA).

Aneks 5 Investimet publike

Emërtimi i projektit	Kosto (në milion lekë)
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	
Rep.Usht.Nr.6000 Tirane	156
Rep.Usht.Nr.2001 Durrës	3
Rep.Usht.Nr.3001 Tirane	26
Forcat e luftimit	
Rep.Usht.Nr.1100 Zall-Herr	525
Rep.Usht.Nr.1200 Zall-Herr	175
Rep.Usht.Nr.1410 Tirane	13
Rep.Usht.Nr.2230 Durrës (D1D)	124
Rep.Usht.Nr.2240 Vlore (D2D)	981
Rep.Usht.Nr.3340 Tirane (regj.Helik.Farke)	90
Mbeshtetja e luftimit	
Rep.Usht.Nr.1113 (Bt.Mb.F.T)	116
Rep.Usht.Nr.4450 Tirane (Br.Furnizimit)	1271
Rep.Usht.Nr.4460 Tirane (Br.Transportit)	76
Rep.Usht.Nr.6613 Tirane (Bt.P.U.)	119
Mbeshtetja e përqendruar	
Rep.Usht.Nr.4443 Tirane (Laboratori Q.U.)	56
Rep.Usht.Nr.4445 Baza Rip.N.IV	148
Rep.Usht.Nr.6611 Bt.Nd.	6
Rep.Usht.Nr.6620 (Gjeografik)	3
Rep.Usht.Nr.6621 ISPVMb	8
Rep.Usht.Nr.6624 Tirane (Arkivi)	41
Rep.Usht.Nr.6001 SHIU	19
Rep.Usht.Nr.6612 Bt.Mb.Sh.P	18
Rep.Usht.Nr.6623 QKU	8
Rep.Usht.Nr.6637 QSHB	2
Mbeshtetje shendetesore	
Rep.Usht.Nr.6619 (SUQU)	107
Ndërtime ne Qendrën e Traumatologjisë	25
Arsimi ushtarak	
Rep.Usht.Nr.5001 Tirane (KDS)	136
Rep.Usht.Nr.5570 Vlore (Br.Stervitjes)	192

Aneks 6 Projekte të ndihmës së huaj

Emërtimi i projektit	Donatori
Projekti 203 Mbështetje e Br XH	Italia
Projekti 210 Mbështetje e BrRSH	Italia
Projekti 301+304 Mbështetje e Njësive Detare e Shërbimit Hidrografi	Italia
Projekti 303 Mbështetje e Rojes Bregdetare	Italia
Projekti 401 Kontrolli i Trafikut Ajror	Italia
Projekti 403 Organizimi i Shërbimit Meteorologjik	Italia
Projekti 404 Organizimi SAR	Italia
Projekti 407 Mbështetje Shkollës se FA	Italia
Projekti 408 Mbështetje e Regjimentit te Helikopterëve	Italia
Projekti 101 Mbështetje MM e SHP	Italia
Projekti 107 Mbështetje Shëndetësisë	Italia
Projekti 110 Mbështetje KDS	Italia
Projekti 113 Mbështetje BPU dhe BMC	Italia
Projekti 112 Organizimi Logjistiko-Administrativ	Italia
Marrëveshja për Spitalin Ushtarak Gjirokastër	Greqia
Marrëveshja grand për logjistikën ku për fshihen:	Turqia
Mbështetje e kontingjentit tone ne operacionin ALTHEA	Gjermania
Materiale e pajisje mjekësore për SUQU	Gjermania
Projekti për Shkatërrimin e armëve te lehta	MB
Programi “FMF (Foreign Military Funding)”	SHBA
Programi “IMET (International Military Education Training)”	SHBA
Projekti për shkatërrimin e LHL	SHBA
Projekti për shkatërrimin e minave detare	SHBA
Projekti për ndërtimin e LAN dhe PC-s	Danimarka
Projekti për Laboratorin Qendror i F.A.	Zvicra
Projekti për BMC	Zvicra
Projekti për ANO	Holanda
Projekti për Rojen Bregdetare	Holanda
NAMSA	Te ndryshëm
Projektet me CARDS-IPA	Te ndryshëm
Mbështetje financiare për realizimin e PG-ve A-4054 dhe A-4150	Franca

